



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I ASETËVE

Nr. 14521 prot

Lezhë me. 23.08.2021

SHPALLJE

(PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE)

Në mbështetje të ligji nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe bazuar në ligjin nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” si dhe VKM-në nr.179, datë 26.02.2020 Për rregullat , kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave shtetërore që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992. Ju bëjmë me dije se pranë, Bashkisë Lezhë është depozituar aplikimi me nr. 197 prot, datë, 09.01.2018, me kërkues Z. Gjin Dod Arra, banuese në Balldre Njësia Administrative Balldre ku kërkon përfundimin e proçedurave të privatizimit të banesës .

Banesa nr. 10, kati 1 ,shkalla 2 Balldre, Njesia Administrative Balldre.

Ju vëmë në dijeni se në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr.64 ,datë 25.05.2018, Z. Gjin Dod Arra dhe znj.Albina Nik Arra të cilët janë në çertifikatën familjare të datës 01.12.1992, të paraqiten pranë zyrës së aseteve, Bashkia Lezhë për përfundimin e proçedurave të privatizimit .

Kjo shpallje bëhet në (tre) kopje, njëra prej të cilave afishohet pranë Njesise Administrative Balldre, në ambjentet e jashtme në pjesën e dukshme nga publiku, një kopje tjetër afishohet nga Bashkia Lezhë, si dhe në faqen e sajë zyrtare on-line, ndërsa kopja e tretë i bashkëngjitet si pjesë e dokumentacionit të dosjes.

Nëse ndonjë nga personat që ndollet në çertifikatën familjare të datës 01.12.1992 nuk paraqitet pranë noterit për të përfunduar privatizimin e banesës atëherë do të vijohet të veprohet në bazë të VKM-në nr.179 datë 26.02.2020 pika 33 që thotë : Nëse pas 3 muajve nga shpallja publike personi përsëri nuk paraqitet, atëherë procedura e privatizimit vijon dhe kontrata lidhet me antarët të tjerë madhorë të familjes.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Reinis Çela

